

Statuti dhe Akti i themelimit
I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
“American Auto Albania”

Sot ne Tirane, ne **Daten 14.06.2023** , Ortaku I Vetem I Shoqerise, “ American Auto Albania shpk”, **Z.Kleidi Papa**, mbajtes i dokumentit te identifikimit me **Nr. J41111074Q**, I thirrur dhe I mbledhur rregullisht ne Seline e Shoqerise me adrese: Zona kadestrale Nr.1212, Nr.Pasurie 145/13, Vol.4, Fq. 170, Blerimaj , Kavaje, ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, Nr. 1, Date 14.06.2023 vendosi Themelimin dhe Statutin e shoqerise.

Kreu I
Emertimi i shoqerise, forma Juridike, Selia, Objekti, Kohezgjatja.

Neni 1
Emertimi

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar do te emertohet “**American Auto Albania shpk**” .

Neni 2
Forma Juridike

Shoqeria “ American Auto Albania shpk ” , do te jete Person Juridik, sipas percaktimeve dhe dispozitave ligjore te parashikuara ne Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;

Shoqeria, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate aktivitetit te saj.

Shoqeria “American Auto Albania shpk”, eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, kapitali i saj eshte i ndare ne kuota, ku ortaket e saj mbajne pergjegjesi per humbjen deri ne kufirin e vleres se kontributit qe ata kane investuar ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 3
Selia

Selia e Shoqerise e cila do te jete ne adresen: “Zona kadestrale Nr.1212, Nr.Pasurie 145/13, Vol.4, Fq. 170, Blerimaj , Kavaje. ”

Shoqeria mund te hape ne funksion te aktivitetit te saj tregetar dhe adresa te tjera sekondare, dhe eshte pergjegjese per te njoftuar cdo ndryshim ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4
Objekti

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e:
“ Import dhe Shit-blerje automjesh te perdorura, dhe pjese kembimi per automjete. Makina me qera”

Neni 5 Kohegzjatja

Shoqeria “American Auto Albania shpk”, do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe te pakufizuar kohore duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombete te Biznesit.

Kreu II Kapitali

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete **100 lek.**

Kapitali themeltar do te perbehet nga total **1 kuote**, me vlere nominale **100 lek.**

Ortaku i vetem i shoqerise “American Auto Albania shpk”, zoteron 100% te Kapitalit Themeltar te Shoqerise, saktesisht 1 kuote me vlere nominale 100 lek.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregetueshme. Kontributi i ortakeve mund te jete ne vlere ose ne natyre (pasuri te luajtshme / te paluajtshme, apo te drejta).

Neni 7 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te Kapitalit Themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, kjo nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar, apo nje eksperti te pavarur, te autorizuar, te nenkontraktuar nga shoqeria per te vleresuar keto kontribute, me kerkese te administratorit te shoqerise apo Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje Ortak per te rritur angazhimin e tij ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit mund te autorizohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, e cila e merr kete vendim ne te njejtat kushte te parashikuara edhe per ndryshimin e Statutit te Shoqerise.

Ne te gjitha rastet edhe zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar, ne rast se ka te tille, te pakten 45 dite perpara dates se percaktuar te Asamblese te thirrur per te marre vendim rreth keti projekti.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejttat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

1. Kontributit ne kapitalin e shoqerise ;
2. Shitblerjes;
3. Trashgimise;
4. Dhurimit;
5. Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj;

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solitare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave deri ne castin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

Kreu III

Organet Vendimarrrese dhe Drejtuese

Neni 9

Organi vendimarrres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara me ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b. Ndryshimin e statutit;
- c. Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit te Shoqerise;
- d. Emerimin dhe shkarkimin e Likujduesve dhe Eksperteve Kontabel te autorizuar;
- e. Percaktimin e shperblimeve per personat ne gerrat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f. Mbikqyrjen e zbatimin e politikave tregtare nga administratori, perfshire dhe pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h. Zmadhim dhe zvogelim te kapitalit;
- i. Perfaqesim te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera ndaj administratoreve;
- j. Riorganizim dhe prishje te shoqerise;
- k. Shnderrimin ne nje forme tjeter;
- l. Miratim te rregullave proceduriale te mbledhjeve te Asamblese;
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji apo Statuti;

Ortaku mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme ne baze te nje autorizimi, nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Autorizimi per perfaqesim te ortakut mund te jepet dhe te jete i vlefshem vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese ne te njejtin rend dite.

Administratori i Shoqerise, nese eshte nje person i trete i ndryshem nga Ortaket e Shoqerise, nuk mund te veproj si perfaqesues i ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme.

Neni 10 **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrim ose nje njoftimi nepermjet postes elektronike nga Administratori i Shoqerise me kerkese te ortakeve.

Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten dhe oren e mbledhjes, si dhe rendin e dites, dhe duhet t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas percaktimeve sipas ketij neni, ajo mund te marre vendime qe konsiderohen te vlefshme, vetem nese te gjithe ortaket jane dakort per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

Neni 11 **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave.

Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendos per ceshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te ngrihet per shkak te mungeses se Kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, ne te njejtin rend dite.

Neni 12 **Marrja e vendimeve**

Asambleja e Pergjithshme per marrjen e vendimeve te percaktuara ne nenin 9, kreu 3, zhvillon mbledhje te jashtezakonshme te cilat jane te vlefshme kur jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te kuotave.

Cdo ndryshim statuti i shoqerise nga Asambleja e Pergjithshme, i bere konform dispozitave te paracaktuara, duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 13 **Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator, qe do te percaktohet me Vendim te Asamblese se Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoj Administratorin me nje shumice te zakonshme.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund ta perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

Administratori mund te shkarkohet nga Gjykata per shkelje te ligjit dhe me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.

Percaktimi i administratorit dhe cdo ndryshim i tij njoftohet per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Emerimi i Administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Administratori i shoqerise mund te emerohet ortaku i saj ose dhe nje person jashte ortakerise.

Neni 14 **Kompetencat**

Administratori ka te drejte:

- a. Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
- b. Te perfaqesoj shoqerine tregtare;
- c. Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d. Supervizon pergatitjen e pasqyrave financiare dhe bilancin vjetor si dhe miraton raportet e ecurise se veprimtarise dhe sebashku me propozimet e shperndarjeve te fitimeve i pararqet kto dokumenta perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e. Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f. Kryen regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne Ligjin per qendren kombetare te regjistrimit;
- g. Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe statut;

Administratori eshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:

- a. Me kerkese te secilit nga ortaket e shoqerise;
- b. Per qellim parashtrimin e raporteve financiare bilanceve vjetore si dhe raporteve te tjera objekt miratimi i Asamblese se Pergjithshme;
- c. Ne raste kur ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda tre muajve dhe ne vazhdim;
- d. Si dhe detyrimet e tjera te parashikuara nga ligji per tregetaret dhe shoqerite tregetare;

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem.

Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjith personave fizik e juridik, publik dhe/ ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ktu autoriteteve gjyqesore te te gjitha shkalleve.

Administratori ka te gjitha kopetencat per te vepruar me marredhenie me te tretet ne emer te Shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kopetencave qe ligj ja jep shprehimisht Ortakeve te Shoqerise.

Administrator angazhon shoqerine ne marredhenie me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise, si dhe kopetencat e administratorit te saj.

Neni 15 **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise. Pasojat e marreveshjeve te pa miratuara nga Asamblija e Pergjithshme sipas dispozitave dhe menyres se miratimit te percaktuara ne kete statut, qe i sjellin dem shoqerise i ngarkohen Administratorit, si dhe ortakut qe ka bere marreveshjen (ne rastet kur), per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara bazuar ne Ligj dhe Statut.

Pervecse eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise sipas neneve 14,15,17 e 18 te ligjit "Per Tregetaret e Shoqerite tregetare", Administratori detyrohet:

- a. Te kryeje detyrat e percaktuara ne Ligj e ne Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemndje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis
- b. Te ushtroje kopetencat qe i njihen ne ligj dhe Statut vetem per arritjen e qellimeve te percakuara ne keto dispozita
- c. Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim
- d. Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit prezent apo te mundshem te interesave personale me ato te shoqerise
- e. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

Administratori gjate kryerjes se detyrave te tij pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mos veprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mos veprimi eshte kryer ne mirebesim.

Ortaket individualisht ose se bashku kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit, nese verehen shkellje me pasoje deme per shoqerine. Kane te drejte ta ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e demit qe i eshte shkaktuar Shoqerise, perfshire dhe demshperblim Financiar, nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim i Asamblese se Pergjithshme nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder Administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Kreu IV
Viti Financiar, Bilancet dhe Dividentet

Neni 16
Viti financiar

Viti Financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
Perjashtimisht viti i pare fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te biznesit (QKB) dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17
Bilanci i Shoqerise dhe Dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve miraton Bilancin Vjetor e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e ortakeve vendos rreth shperndarjes se Dividentit pasi ti jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar sic edhe parashikohet nga ligji.

Kreu V
Shperndarja ose Likuidimi i Shoqerise, Bashkimi, Ndarja, Shnderrimi

Neni 18
Shperndarja ose Likuidimi i Shoqerise

Shperndarja ose Likuidimi i shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentimit
- d. Me vendim gjykate
- e. Cdo forme apo rrethane tjeter e parashikuar nga Ligji

Prishja e Shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortakate ne vendim te Asamblese se pergjithshme te ortakeve.

Ne rastet kur nuk eshte percaktuar nga ana e ortakeve te Shoqerise nje likuidues, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar, mund ti drejtohet gjykates per te caktuar nje Likuidues.

Neni 19
Te drejtat dhe detyrimet e Likuiduesve

1. Detyra e Likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te Shoqerise, mbledhja e kredive t pa arketuara dhe kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe

shlyerja e kreditoreve duke respektuar rradhen e referimit sipas nenit 605 te kodit civil.

2. likuiduesi mund te kryeje dhe veprime te reja tregtare per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
3. Nese ne baze te pretendimeve te ngritura nga Kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare likuiduesit verejne se Shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pa shlyera nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, Likuiduesi detyrohet te pezulloje proceduren e Likuidimit e ti kerkoje Gfjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Neni 20 Perfundimi i Likuidimit

Pas Shperndarjes se Aktiveve te mbetura, Likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e Likuidimit dhe kerkon c' regjistrimin e Shoqerise ne perputhje me Seksioni 5 te ligjit "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Neni 21 Bashkimi

Dy ose me shume Shoqeri mund te bashkohen nepermjet:

1. Kalimit te te gjite aktiveve dhe pasive te njerës apo me shume shoqerive qe quhen shoqerite perthithura, te nje shoqeri tjeter egzistuese e quajtur Shoqeria perthithese.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet apo pasive e shoqerise egzistuese, qe bashkohen ne kembim te kuotave ne shoqerine e e re.

Neni 22 Ndarja

Rastet kur mund te ndahet nje Shoqeri:

1. Nje Shoqeri mund te ndahet me vensim te Asamblese se Ortakeve duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume Shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet vleresohet e prishur.
2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008
3. Shoqerite qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet quhen shoqeri pritese dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.
4. Regjisrtimi i ndarjes se shoqerise prane qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje:
 - a. Kalimini e shoqerise pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet ne perputhje me raportin e ndarjes te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive si dhe per palet e treta;
 - b. Berjen e aksionereve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritese ne perputhje me raportin e ndarjes percaktuar ne marreveshjen e ndarjes;

- c. Vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe c'regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit sipas seksionit 5 te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23
Shnderrimi

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore nepermjet shndrrimit te saj ne shoqeri aksionere.

Kjo nuk sjell pasoja mbi te drejtat dhe detyrimet qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

Kreu VI

Mosmarveshjet, Baza Ligjore, Dispozita te pergjithshme

Neni 24
Mosmarveshjet

Mosmarveshjet qe mund te lindin, mund te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Shkalles se pare Tirane.

Neni 25
Baza ligjore

1. Kushtetuta e Republikes se Shqiperise;
2. Ligji Nr 9901, date 14.04.2008, "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare";
3. Ligji Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
4. Kodi Civil;
5. Ligji Nr. 9920, Date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise", I Ndryshuar;
6. Ligji nr. 8449, date 27.01.1999 " Kodi Doganor", I Ndryshuar;

Neni 26
Dispozita te pergjithshme

Ky statut u perpilua ne 2 (Dy) kopje me permbajtje dhe vlere te njejte juridike, u miratua Nen per Nen nga Ortaku Themelues te Shoqerise Tregetare "**American Auto Albania sh.p.k**"

Ortaku I Vetem I Shoqerise
American Auto Albania sh.p.k
Z. Kleidi Papa
